Numër: 01/656
Datë: 30.11.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Ri-akreditohet** institucioni "CAMELLIAS", me adresë: Rr. Enver Maloku, Nr. 4, Lim Projekt, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 25.07.2021 deri më 24.07.2024, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 MANIKYRIST/E, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 6 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga pesë (5) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në katërmbëdhjetë (14) grupe.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit "CAMELLIAS", për rivalidim, riakreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi rivalidimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të

kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "CAMELLIAS", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK